

Vendim nr. 192 datë 23.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 23.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: MYLAIM BEHELULI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 332, datë 02.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2018-480/121, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-1944, datë 16.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 332, datë 02.05.2017, ndër të tjera, ka deklaruar fajtor kërkuesin Mylaim Beheluli për veprat penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, me pasojë plagosjen e lehtë të tre shtetasve dhe të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, me pasojë vdekjen e një shtetasi, të parashikuara nga nenet 290, paragrafi i parë dhe 290, paragrafi i tretë, të Kodit Penal dhe, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar përfundimisht atë me 2 vjet burgim, si dhe me 1 vit ndalim për të drejtuar automjete.

2. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi për pjesën që dispononte për kërkuesin është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2018-480/121, datë 05.03.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1944, datë 16.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

3. Në datën 27.06.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat edhe pse kanë qenë përpara akteve të ekspertimit me konkluzione të ndryshme, nuk kanë pranuar kryerjen e një akti ekspertimi nga një grup ekspertësh. Për pasojë, sipas tij, nuk është gjetur shkak i ngjarjes aksidentale dhe as faktori i vërtetë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me

shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

6. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai kundërshton procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur fajësia dhe dënimi penal për akuzat e ngritura ndaj tij, rrjedhimisht ka interes në çështjen e parashtruar.

7. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës. Lidhur me këtë kriter, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për pasojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

8. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 16.11.2023 të Gjykatës së Lartë, që është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 24.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.06.2024, pra pas 5 muajve e 2 ditësh. Kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 13.05.2024, kur atij i është kthyer përgjigje me shkrim nga ajo gjykatë.

10. Duke analizuar të dhënat e mësipërme në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka marrë njoftim për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 24.01.2024, kur ai është publikuar në faqen zyrtare dhe është bërë i disponueshëm për palët. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, Kolegji mban në konsideratë se

procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuesi me paraqitjen e rekursit, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndaj ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Po kështu, Kolegji vëren se detajet e çështjes së kërkuetit, përfshirë datën e numrin e vendimit, statusin e çështjes “mbyllur” dhe një kopje e vendimit objekt kundërshtimi, rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, Kolegji konstaton se në rekursin e paraqitur bashkëlidhur kërkesës nuk rezulton që avokati i kërkuetit të jetë kujdesur për të shënuar të dhënat elektronike të kontaktit, me qëllim realizimin e njoftimeve nga sekretaria e asaj gjykate, çka do të mundësonte njoftimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Nga ana tjetër, argumenti i kërkuetit se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në kohën kur kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkrim atij nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të provuar momentin e konstatimit të cenimit, për sa kohë që një informacion i tillë mund të kërkohej në çdo rast dhe në çdo kohë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor. Nën këtë analizë, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual është paraqitur nga kërkuesi jashtë afatit ligjor 4-mujor.

11. Për më tepër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuetit nuk përmbushin as kriterin *ratione materiae*. Konkretisht, në përmbajtje të ankimit kushtetues individual, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat, edhe pse kanë qenë përpara akteve të ekspertimit me konkluzione të ndryshme, nuk kanë pranuar kryerjen e një akti ekspertimi nga një grup ekspertësh e, për pasojë, nuk është gjetur shkak i ngjarjes aksidentale dhe as fajtori i vërtetë. Këto argumente, në thelb, lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave, gjë e cila është atribut i gjykatave të zakonshme. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se interpretimi i ligjit material e procedural dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuetit janë haptazi të pabazuara dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 23.09.2024